



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1581, datë 26.04.2011

Për

“Miratimin e disa rregullave për sipërmarrësin Albtelecom sh.a. për implementimin e Portabilitetit të Numrit”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 26.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimi i disa rregullave për sipërmarrësin Albtelecom sh.a. për implementimin e Portabilitetit të Numrit.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja p) e nenit 8, neni 42, neni 49, neni 87 dhe 88 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
3. Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” (*Rregullorja*).

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projektakti i hartuar nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik “Disa rregulla për sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., për implementimin e Portabilitetit të Numrit” (*Projektakti*);
 2. Relacioni shoqërues i projektaktit (*Relacioni*);
- Si dhe,
3. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. AKEP, në kuadër të nxjerrjes së akteve administrative normative të karakterit të përgjithshëm dhe individual me qëllim plotësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator për implementimin me sukses të Portabilitetit të Numrit, me vendime e Këshillit Drejtues Nr. 1559, 1560 dhe 1561, datë 20. 04. 2011, vendosi respektivisht imponimin e disa ndryshimeve në Ofertat Referencë të Interkoneksionit për sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., Eagle Mobile Sh.a., dhe AMC Sh.a., duke sanksionuar disa rregulla lidhur me rrugëzimin e trafikut drejt numrave të portuar në rrjetet celulare dhe detyrimet midis palëve.
2. Nevoja e vendosjes së këtyre rregullave duke patur parasysh rrethanat në të cilat do të fillojë implementimi i zbatimit të Portabilitetit të Numrit nga operatorët celularë, nxjerr domosdoshmërinë e nxjerrjes së disa rregullave të këtij karakteri edhe për sipërmarrësin me FNT të telefonisë fikse Albtelecom Sh.a., me qëllim mundësimin e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve drejt numrave të portuar në rrjetet celulare edhe fikse, duke patur parasysh këtu edhe rrjetet e operatorëve alternativë .
3. Oferta Referencë e Interkoneksionit për sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., është në proces shqyrtimi nga AKEP ndërkohë që afati i fillimit të implementimit të Portabilitetit të Numrit, është i më i shpejtë.
4. Rregullat e hartuara nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik për sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., për implementimin e Portabilitetit të Numrit me qëllim qartësimin e marrëdhënieve midis Albtelecom-it dhe operatorëve alternativë për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve drejt numrave të portuar në rrjetet celulare dhe fikse, janë në përputhje me dispozitat referuese të përcaktuara në ligjin nr. 9918, Rregullorja, etj., për këtë qëllim.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësine e miratimit të këtij dokumenti për konkurrencën në treg, sipërmarrësit dhe realizimin e objektivave rregullatore lidhur me zbatimin e Portabilitetit të Numrit, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë aktin normativ “ **Rregulla për sipërmarrësin Albtelcom sh.a. për implementimin e Portabilitetit të Numrit**”, sipas dokumentit Lidhja Nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Albtelcom sh.a. të publikojë në faqen e tij të Internetit, aktin e miratuar normativ sipas këtij vendimi, brenda një jave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Albtelcom sh.a dhe palët e interesuara, kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ, për këtë vendim, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

**RREGULLA PËR SIPËRMARRËSIN ALBTELECOM SH.A., PËR
IMPLEMENTIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT**

I. Marrëveshjet e Interkoneksionit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., të lidhura me operatorët vendas (si edhe RIO e Albtelecom) do të mbulojnë dhe sipas rastit specifik do të duhet që të përfshijnë:

1. Terminimin dhe orgjinimin e thirrjeve drejt dhe nga pajtimtaret/abonentet e rrjetit Albtelecom.

Abonent/pajtimtar i rrjetit Albtelecom: *abonentet/pajtimtaret qe:*

1. Kane numer qe i perket serive numerike të alokuar nga AKEP Albtelecom-it, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Albtelecom, por qe eshte portuar ne rrjetin e Albtelecom.

Albtelecom ka detyrimin të pranojë për terminim vetëm thirrje telefonike të destinuar për abonentet/pajtimtaret e Albtelecom, të cituar më sipër, dhe është përgjegjësia e operatorit përfitues të rrugëzojë thirrjet drejt rrjetit të duhur për numrat e portuar, duke bërë analizën e thirrjeve në përputhje me rregullat e vendosur nga AKEP për portabilitetin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve drejt tyre.

2. Terminimin e thirrjeve drejt pajtimtaret/abonentet te rrjetit te operatorit perfitues.

Abonent/pajtimtar i rrjetit te Operatorit Perfitues *abonentet/pajtimtaret qe:*

1. Kane numer qe i perket serive numerike të alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, por qe eshte portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues.

Operatori përfitues ka detyrimin të pranojë për terminim vetëm thirrje telefonike të destinuar për abonentet/pajtimtaret e tij, të cituar më sipër, dhe është përgjegjësia e Albtelecom të rrugëzojë thirrjet drejt rrjetit të duhur për numrat e portuar, duke bërë analizën e thirrjeve në përputhje me rregullat e vendosur nga AKEP për portabilitetin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve drejt tyre.

3. tranzitim e thirrjeve nga Albtelecom drejt rrjeteve kombetare per:

- a) Operatoret te cilet kane një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar ;
- b) Operatoret te cilet nuk kane një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar,

sipas kushteve te dhena më poshtë.

1. Operatori perfitues qe ka një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar:

- ka detyrimin qe te percjelle thirrjet drejt Albtelecom per tranzitim ne rrjetet e tjera kombetare me kodin perkates te rrugezimit te operatorit drejt te cilit duhet te shkoje thirrja.
- Do te tarifohet per detyrimin per terminimin e thirrjeve drejt numrave te portuar sipas tarifes se terminimit te rrjetit ku ndodhet numri i portuar (rrjeti marres).

Pagesat shtese/kompensimi nga tarifat e ndryshme te terminimit ne rrjetin dhurues dhe marres te numrit do te perfshihen ne faturen e muajit perkates te leshuar nga Albtelecom.

2. Operatori perfitues qe nuk ka një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar:

- Do te nenshkruaje nje Aneks shtese te marrevshjes se interkoneksionit, aneks i cili do te permbaje marrveshjen komerciale (nuk eshte pjese e RIO) me Albtelcom. Ky Aneks do te permbaje midis te tjerave:
 - o Pranimin nga palet per kryerjen e analizes se thirrjeve per tranzitim nga Albtelecom;
 - o Detyrimin e operatorit perfitues per te paguar Albtelecom:
 - detyrimin per terminimin e thirrjeve drejt numrave te portuar sipas tarifes se terminimit te rrjetit ku ndodhet numri i portuar (rrjeti marres).
 - nje tarife shtese mbi tarifen perkatese te tranzitimit, tarife analize thirrje e shprehur ne lek/thirrje dhe/ose nje pagese fikse per shërbimin.

Pagesat shtese/kompensimi nga tarifat e ndryshme te terminimit ne rrjetin dhurues dhe marres te numrit si dhe pagesa per analizen e thirrjeve do te perfshihen ne faturen e muajit perkates te leshuar nga Albtelecom.

Shërbimi i analizës së thirrjeve nga Albtelcom për operatorin përfitues, ofrohet në bazë të një marrëveshje komerciale (përfshirë si aneks i MI) dhe tarifat për analizën e thirrjeve janë komerciale, ndërsa për tranzitimin dhe terminimin aplikohen tarifat sipas vendimeve në fuqi të AKEP.